

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
Nr. Indeksi 6708
Nr. Dosje 1148



KONTRATË SHITJE AKSIONESH

Sot më datë 22 Nëntor 2006 (dy mijë e gjashtë) (Data e nënshkrimit) në Tiranë, para meje, ARIAN MERKURI, Noter Publik në Dhomën e Noterëve, Tiranë u paraqitën personalisht:

Suzana Mara, shtetase shqiptar, lindur në Tiranë, më 25.4.1958, mbajtëse e pasaportës nr. Z0594138, madhore, dhe me përgjegjësi të plota ligjore për të vepruar, e përfaqësuar rregullisht nga Znj. Edlira Margilaj, madhore, me përgjegjësi të plota ligjore për të vepruar, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë, më 29.03.1986, mbajtëse e pasaportës Nr. Z1575873, me anë të Prokurës me Nr. Indeksi _____, Nr. 54033, datë 20 Nëntor 2006, përpiluar nga Noteri Publik F. Forcelli, dhe:

“**ALBECORP**” SHPK, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar dhe që funksionon sipas Ligjeve të Shtetit Shqiptar, e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë, me Vendim nr. 12234, të datës 25.9.1995, e përfaqësuar rregullisht nga Znj. Edlira Margilaj, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë, më 29.03.1986, mbajtëse e pasaportës Nr. Z1575873, madhore, dhe me aftësi të plota ligjore për të vepruar, me anë të Prokurës me Nr. Indeksi 103, Nr. Dosje 9, datë 10.01.2005, përpiluar nga Noteri Publik Agim Robo;

nga ana tjetër si “*Aksionar Hyrës dhe Shitësit*”;

Anatoli Belchev, shtetas bullgar, lindur në Razgrad, Bullgari, më 22.02.1961, mbajtës i pasaportës Nr. 344483236, madhor, dhe me përgjegjësi të plota ligjore për të vepruar;

Përparim Kalo, shtetas shqiptar, lindur në Kucovë, Shqipëri, më 12.12.1957, mbajtës i pasaportës Nr. Z01116065, madhor, dhe me përgjegjësi të plota ligjore për të vepruar;

nga ana tjetër si “*Investitorët dhe Blerësit*”

Aksionarët Dalës dhe Aksionarët Hyrës, gjithashtu mund të referohen si, “**Pala**” ose në bashkërisht “**Palët**”.

NDERSA

Aksionarët Hyrës dhe Shitësit janë zotërues të 60 për qind të aksioneve të "Televizionit Arbëria" SHA ("Aksionet"), një Shoqëri Aksionare pa ofertë publike, e themeluar dhe që funksionon sipas ligjeve të shtetit shqiptar, e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë, me Vendim Nr. 22058, datë 4.10.1999, me Seli në adresën: "Pallati i Madh i Kulturës, Sheshi Skënderbej, Tiranë, Shqipëri, ("Shoqëria") e blerë në datën 3.5.2006, sipas Kontratës së Shitjes së Aksioneve, nënshkruar përpara Noterit Publik Z. Agim Robo me Nr. Indeksi 5528, Nr. Dosje 722, nga Z. Artan Sovrani, 20% Z. Arjan Lamaj 40%;


- B) Kontrata e Shitjes së Aksioneve, është depozituar në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë, me Vendim Nr. 22058/10, datë 4.5.2006.
- C) Sipas Pikës 3 të Kontratës së Shitjes së Aksioneve, "Mënyra e Pagesës", cmimi i shitjes së aksioneve duhet të paguhet sipas afateve të mëposhtme:

Sipas Kontratës së Shitjes së Aksioneve shuma e përcaktuar për shitjen e 20% të aksioneve të Shitësit ARTAN SEVRANI, nga blerësi Znj. SUZANA MARA do të paguhet si më poshtë:

- Kësti i parë prej 50 000 Euro cash, brenda muajit Maj 2006 e vërtuar kjo me konfirmim bankar.
- Kësti i dytë prej 233.333 (dyqinde e tridhjetë e tre mijë e treqindë e tridhjetë e tre) Euro, do të paguhet brenda datës 30.07.2006).
- Kësti i tretë prej 183.333 (njëqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) Euro, do të paguhet brenda datës 30.10.2006.

Sipas Kontratës së Shitjes së Aksioneve, shuma e përcaktuar për shitjen e 40% të aksioneve të Shitësit Z. Arjan Laman nga blerësi Shoqëria ALBECORP SH.P.K do të paguhet në katër këste si më poshtë:

- Kësti i parë prej 50 000 Euro cash, brenda muajit Maj 2006 e vërtuar kjo me konfirmim bankar.
- Kësti i dytë prej 233.333 (dyqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) Euro, do të shlyhet brenda datës 30.01.2007.
- Kësti i tretë prej 233.333 (dyqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) Euro, do të shlyhet brenda datës 30.04.2007.
- Kësti i katërt prej 233.333 (dyqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) Euro, do të shlyhet brenda datës 30.07.2007.
- Kësti i pestë prej 183.333 (njëqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) Euro, do të paguhet brenda datës 30.10.2007



Aksionarët Hyrës dhe Shitësit, pranojnë se për arsye të ndryshme, nuk arritën t'i
Aksionarëve Dalës emimin e shitjes së aksioneve sic parashikohet në
Kontratë e Shitjes së Aksioneve, dhe

Aksionarët Hyrës dhe Shitësit marrin përsipër të rregullojnë shkeljet duke lidhur këtë
Kontratë, me Investitorët dhe Blerësit, sipas kushteve të mëposhtme:

PËRKUFIZIME

Në këtë Kontratë të Shites së Aksioneve, ("**Kontrata**") vetëm nëse kërkohet ndryshe nga konteksti:

"**Shoqëria**" është Televizioni Arbëria, Shoqëri Aksionare e themeluar dhe që funksionon sipas ligjeve të shtetit shqiptar, e regjistruar në Regjistrin e Shoqërive Tregtare të Gjykatës së Rrethit Tiranë, me Vendim Nr. 22058, datë 4.10.1999, me Seli në adresën: "Pallati i Madh i Kulturës, Sheshi Skënderbej, Tiranë, Shqipëri.

"**TVA**" është Televizioni Arbëria, Shoqëri Aksionare e themeluar dhe që funksionon sipas ligjeve të shtetit shqiptar, e regjistruar në Regjistrin e Shoqërive Tregtare të Gjykatës së Rrethit Tiranë, me Vendim Nr. 22058, datë 04.10.1999, zotërues i licencës si Operator Kombëtar Televiziv, që ka në zotërim, Kanalin Televiziv TVA (**Shoqëria**)

"**Filial**" është, sa i përket Investitorit cdo person që (A) kontrollon Investitorin (B) kontrollohet nga kjo Palë (C) ose kontrollohet nga një person me kompetencat e parashikuara në pikën (A); sipas përkufizimit, "**kontrollon**" ose "**kontrollohet**" në përgjithësi nënkupton zotërim, në mënyrë drejtpërdrejtë ose tërthorazi, vetëm ose bashkërisht, të kompetencës për të drejtuar ose nxitur administrimin ose politikën e një personi (qoftë përmes zotërimit të aksioneve, aksionarit tjetër, ortakërisë ose interesit të pronësisë duke krijuar identitet të plotë ose të pjesshëm të personave drejtues me anë të Kontratës ose në mënyrë tjetër):

"**Ligji Shqiptar**" janë ligjet dhe rregulloret të cilat rregullojnë, krijimin, regjistrimin, formën dhe përmbajtjen e Statutit të Shoqërisë, funksionimin e saj, ligjet dhe aktet nën-ligjore për transmetimet televizive dhe veprimtari të tjera të ngjashme në Shqipëri.

"**Periudhë Ekskluziviteti**" është periudha prej 60 ditësh nga dita e nënshkrimit të Memorandumit ndërmjet Investitorit, Aksionarëve Dalës dhe Aksionarëve Hyrës;

"**Memorandum Mirëkuptimi**" është marrëveshja ndërmjet Aksionarëve Dalës dhe Aksionarëve Hyrës me Investitorin, e nënshkruar në 17 Nëntor 2006.

"**Aksionari i Mbetur**" është Z. Ardian Takaj, aksionar mi Shoqërisë që nuk është palë e Marrëveshjes ose e Memorandumit të Mirëkuptimit;

"**Aksionet**" janë 60% e aksioneve të Shoqërisë, të zotëruara nga Aksionarët Hyrës.

"**Dokumentet e Transaksionit**" janë Marrëveshja, Statuti i ri i propozuar, dhe marrëveshje të tjera të nevojshme për qëllimet e Transaksionit;

është zotërimi nga Investitori i aksioneve që përfaqësojnë të paktën aksioneve me të drejtë vote të TVA-së.

INTERPRETIMI

sipas kontekstit, fjalët në njëjës do të kenë gjithashtu kuptimin e shumësit dhe anasjelltas.

2 Titujt në këtë Kontratë, janë vetëm shpjeguese dhe nuk ndikojnë interpretimin e saj.

Të gjitha shpjegimet e Kontratës për "pikën", "paragrafin", "pjesën e bashkëngjitur" i referohen pikës përkatëse në paragrafin ose pjesën e bashkëngjitur të saj.

2.3 Për llogaritjen e kohëzgjatjes së përcaktuar në Ditë Pune, dita e parë nuk do të përfshihet, ndërsa dita e fundit po.

3. QËLLIMI I MARRËVESHJES

3.1 Investitori dhe Blerësit, kanë rënë dakord në Memorandumin e Mirëkuptimit të blejnë 60% të aksioneve Shoqërisë të zotëruara nga Aksionarët Hyrës dhe Blerësit, perkatesisht te 20 % te aksioneve te TVA te zoteruara nga Suzana Mara tek Z. Perpaim Kalo dhe 40 % te aksioneve te TVA te zoteruara nga "ALBECORP" SHPK tel z. Anatoli Belchev.

3.2 Përmes kësaj Kontrate, Investitori dhe Blerësit marrin përsipër të blejnë 100% të aksioneve që zotërojnë Aksionarët Hyrës dhe Shitësit, të cilat përbëjnë 60% të aksioneve të kapitalit aksionar të Shoqërisë, brenda Periudhës së Ekskluzivitetit, që do të varet nga:

- (i) përmbushja e të gjitha veprimeve që parashikohen në Memorandumin Mirëkuptimit në mënyrë të kënaqëshme për Investitorin;
- (ii) miratimi i Dokumenteve të Transaksionit nga Palët;
- (iii) përmbushja e duhur e të gjitha kushteve (paraprake) të cilat parashikohen në Memorandumin e Mirëkuptimit, i cili është dokumenti kryesor i ndjekur nga kjo Kontrartë dhe Kushtet Paraprake të saj;

3.3 Megjithëse Kontrata përmban detyrime, ndaj Investitorëve dhe Blerësve, Investitorët dhe Blerësit dhe Aksionarët Hyrës dhe Shitësit, kanë rënë dakord që kjo Kontratë do të zgjidhet menjëherë dhe aksionet e regjistruara me anë të depozitimit të Aktit të Shitjes në Gjykatën e Tiranës do të çregjistrohen me anë të një Kontrate të re Ri-Shitjeje, ndërmjet Investitorëve dhe Blerësve dhe Aksionarëve Dalës dhe këto aksione do të regjistrohen me emrat e Askionarëve Dalës sic parashikohet në Memorandumin e Mirëkuptimit. Shpenzimet për këtë kalim do të jenë në ngarkim të Investitorëve, përvec rasteve kur zgjidhja shkaktohet nga shkeljet materiale të Aksionarëve Hyrës dhe Shitësve, gjatë Periudhës së Ekskluzivitetit.

3.4 Kontrata zëvendëson çdo marrëveshje të mëparshme ose angazhim ndërmjet Investitorëve dhe Blerësve dhe Aksionarëve Hyrës dhe Shitësve, pa përmendur Memorandumin e Mirëkuptimit të lidhur ndërmjet Palëve.

3.5 Kalimi i titullit të pronësisë së Aksioneve nga Aksionarët Hyrës tek Invstitorët dhe Blerësit, do të kryhet dhe do të jetë i vlefshëm nga data e Mbarimit sipas pikës 6 më poshtë.

Aksionarët Hyrës, bashkërisht ose vecmas, mbajnë përgjegjësi për përmbushjen e të gjitha detyrimeve që dalin nga Kontrata.

CMIMI I SHITJES

Investitorët dhe Blerësit dhe Aksionarët Hyrës dhe Shitësit, kanë rënë dakort që cmimi i Shitjes do të jetë në shumën 3000 EURO (tre mijë Euro) që do të paguhet Aksionarëve Hyrës dhe Shitësve sa më poshtë:

Suzana Mara – 1,000 Euro (një mijë Euro): dhe

ALBECOP SH.p.k 2,000 Euro (dy mijë Euro)

- 4.2 Cmimi i Shitjes do të paguhet në llogarinë bankare të Aksionarëve Hyrës dhe Shitësve të paktën 3 (tre) Ditë Pune para Datës së Mbarimit.

5. PERIUDHA E EKSKLUZIVITETIT

- 5.1 Investitorët dhe Blerësit do të shfrytëzojnë Periudhën e Ekskluzivitetit për të përgatitur Due Diligence dhe për t'i bërë të ditur Aksionarëve Hyrës dhe Shitësve, nëse do të marrin drejtimin e përhershëm të Shoqërisë ose do të tërhiqen nga pronësia dhe administrimi i saj.

6. KUSHTET PARAPRAKE

- 6.1 Pagesa e Cmimit të Shitjes sipas kësaj Kontrate do të bëhet nga Investitorët dhe Blerësit i nënshtrohen plotësisht të Kushteve Paraprake të mëposhtme:

- 6.1 Organi kompetent i Shoqërisë së Investitorëve ka miratuar pagesën e Cmimit të Shitjes;
- 6.1.2 Të gjitha Dokumentet e nevojshme të Transaksionit janë nënshkruar rregullisht nga Palët;
- 6.1.3 Autoritetet Rregullore Vendore (nëse ka) kanë miratuar për sa më sipër në mënyrë të pa-kundërshtueshme dhe të pakthyeshme.
- 6.1.4 Kalimin e Aksioneve në regjistrin e Aksionarëve ku janë regjistruar Aksionet nga Aksionarët Hyrës dhe Shitësit tek Investitorët dhe Blerësit;
- 6.1.5 Investitorët dhe Blerësit, duhet të kenë marrë lejen, miratimin dhe hapësirën e nevojshme nga Rregullatori i Televizioneve për blerjen e Aksioneve;

- 6.2 Palët do të informojnë njëra-tjetrën për gjëndjen e përmbushjes së Kushteve Paraprake dhe për këtë qëllim Pala do të njoftojë me shkrim palën tjetër sa më sipër brenda 3 (tre) Ditëve Pune nga data e përmbushjes së Kushteve përkatëse Paraprake.

7 MBARIMI

... do të kryhet në ambjentet e Shoqërsisë, vetëm nëse është rënë dakord ndryshe
Palët në një fazë të mëvonshme, sipas përmbushjes ose heqjes dorë prej të gjitha
kushteve Paraprake.

Jo më vonë se 5 (pesë) Ditë Pune nga përmbushja ose heqja dorë nga Kushti Paraprak
dhe marrjes së njoftimit me shkrim ose njoftimit për heqje-dorë, Investitorët dhe
Blerësit do të njoftojë me shkrim Aksionarët Hyrës dhe Shitësit duke përcaktuar datën
kur mbarimi do të jetë kryer (**Data e Mbarimit**), që nuk kalon 5 (pesë) ditë pune nga
data e njoftimit.

7.3 Mbarimi fillon në orën 11.00 të Datës së Mbarimit.

7.4 Në Përfundim, veprimet e mëposhtme duhet të ndërmerren sipas rendit në vijim:

7.4.1 Investitorët dhe Blerësit and Aksionarët Hyrës dhe Shitësit duhet të
paraqesin dokumentet origjinale dhe kopje të tyre, që provojnë pranimin ose
heqjen dorë nga Kushtet Paraprake;

7.4.1 Aksionarët Hyrës duhet të kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme ose të
dëshirueshme për transferimin e Aksioneve tek Investitorët dhe Blerësit,

7.5 Të gjitha veprimet e përmendura dhe të gjitha marrëveshjet që duhet të ndërmerren
në Përfundim, dokumentet dhe mjetet e dërguara, pagesat e kryera do të
konsiderohen si të marra dhe të dërguara ose të kryera dhe efektive njëherësh në
Datën e Përfundimit (me përjashtim kur në marrëveshjet, dokumentat dhe mjetet
është shprehur ndryshe), dhe asnjë veprim, dërgesë ose pagesë nuk do të quhet e
përfunduar derisa të jenë përmbushur të gjitha këto veprime, dërgesa dhe pagesa
karakteristike për Përfundimin.

7.6 Në qoftë se nuk realizohet Përfundimi për shkak të mospërmbushjes dhe mungesës
të heqjes dorë nga ndonjë Kusht Paraprak sipas pikës 5 deri në ditën e kalimit të
afatit për Periudhën e Ekskluzivitetit, secila nga Palët ka të drejtën të zgjidhë me
shkrim me efekt të menjëhershëm këtë Kontratë, pa përmbushjen e ndonjë
formaliteti të mëtejshëm dhe pa qenë e nevojshme për të ndjekur ndonjë procedurë
gjyqësore.

7.7 Pavarësisht nga pika 3, asnjë nga Palët nuk është e detyruar t'i paguajë ndonjë shumë
Palës tjetër në rast se kjo Marrëveshje zgjidhet sipas pikës 6, me përjashtim që
Aksionarët Hyrës duhet të jenë bashkërisht dhe veçmas përgjegjës për t'i paguar
Investitorëve dhe Blerësve të gjitha Dëmet e shkaktuara (duke përfshirë shpenzimet
e transaksioneve dhe koston e këshilltarëve) në rast se kjo Kontratë zgjidhet për
shkak të Kushteve Paraprake sipas pikës 5 të cilat nuk janë përmbushur siç duhet nga
Aksionarët Hyrës në fund të Periudhës së Ekskluzivitetit.

7.8 Përfundimi në vetvete nuk duhet të përbëjë heqje dorë nga secila prej Palëve të të
drejtave lidhur me ndonjë shkellje nga Pala tjetër përpara Përfundimit të përfaqësimit
ose garancisë ose ndonjë ndërmarrje nga Pala tjetër në këtë Kontratë.